




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.1 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyren Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës NR. 03/L – 149, nenit 4 dhe 15 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 5 të Rregullores Nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil si dhe Rregulloren 02/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyren Kombëtare të Auditimit, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

### **KONKURS TË BRENDSHËM** për plotësimin e vendit të punës

|                            |   |
|----------------------------|---|
| Pozita:                    | Zyrtar Certifikues                      |
| Referenca:                 | ZC/ZKA/08-05/18                         |
| Koeficienti:               | 9 (nëntë)                               |
| Numri i pozitave:          | 1 (një)                                 |
| Përgjegjësitë mbikëqyrëse: | Jo                                      |
| I përgjigjet:              | Drejtorit të Përgjithshëm Administrativ |
| Vendi:                     | Prishtinë                               |

#### **Qëllimi i vendit të punës:**

Sigurimi që shpenzimi i parasë publike për çdo aktivitet të institucionit të bëhet në harmoni me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe procedurave tjera nga kjo lëmi.

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Në pajtim me mbikëqyrësin harton planet e punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të divizionit/sektorit dhe jep rekomandime lidhur me objektivat e njësisë; 20%
2. Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet dhe kryen detyra të specializuara në fushën profesionale specifike si dhe ndihmon stafin vartës në ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre; 15%
3. Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të divizionit dhe harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohet; 15%
4. Certifikon realizimin e të gjitha shpenzimeve buxhetore të ZKA-së, 15%;
5. Siguron që kushtet e zbatueshmërisë të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës, 10%
6. Siguron që shpenzimi i parasë publike sipas një kontrate publike të bëhet në pajtim me Rregullat e KMF, dhe që prokurimi është në pajtim me Ligjin mbi prokurimin publik, 10%
7. Siguron se janë plotësuar kushtet e kontratës para se të bëhet pagesa, dhe që kërkesa për pagesë është e koduar në zërin e duhur të shpenzimeve; 10%

8. Siguron që rregullat e KBFP dhe dispozitat tjera ligjore janë respektuar gjatë inicimit dhe realizimit të aktivitetit të prokurimit dhe procedimit të shpenzimeve 5%.

**Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë:**

1. Diplome universitare, drejtimi ekonomik, biznes apo të ngjashme, minimum 3 vite përvojë pune profesionale;
2. Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën profesionale specifike të ftuar përmes arsimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
3. Njohuri të ligjeve dhe rregullorve të aplikueshme;
4. Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
5. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
6. Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Ëord, Excel, Poëer Point, Access, Internetit);

**Procedura e Konkurrimit:**

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunësit civil të Zyrës Kombëtare të Auditimit të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit civil brenda Zyrës Kombëtare të Auditimit. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil.

**Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:**

Kandidatët e interesuar, aplikacionin zyrtar mund ta marrin në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit apo ta shkarkojnë nga faqja e internetit në adresën: <http://www.zka-rks.org/> dhe mund të paraqesin dokumentacionin në kopje fizike në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në adresën: rr. “Musine Kokalari” nr.87-Prishtinë, të aplikojnë përmes faqes së internetit në adresën: [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ose përmes postës.

**Dëshmitë mbështetëse**

**Kandidatët duhet t’ia bashkëngjesisin kopjet e dokumentacionit si:**

- Dëshmitë për kualifikimin shkollor;
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Letër rekomandimet;
- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës dhe
- Kopjen e dokumentit personal të identifikimit.

Konkursi është i hapur tetë (8) ditë nga dita e publikimit në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe tabelën e shpalljeve, duke filluar nga data 17.05.2018 deri më datën 25.05.2018, që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së Konkursit. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin për Burime Njerëzore, në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

**Shënim:**

Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Vetëm formulari zyrtar i aplikacionit do të merret parasysh. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara me dëshmitë mbështetëse do të refuzohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen, gjithashtu edhe kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet do të njoftohen se nuk janë përzgjedhur t'i nënshtrohen procedurës së punësimit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.